

## REFERAT

### PËR ZGJEDHJE/RIZGJEDHJE TË NJË MËSIMDHËNËSI NË TË GJITHA THIRRJET MËSIMORE-SHKENCORE NË LËMIN LETËRSI GJERMANE, TJETËR (6.02.02.17, 6.02.02.30 NGA KLASIFIKIMI I SFERAVE, FUSHAVE DHE LËMENJVE SHKENCORË-HULUMTUES SIPAS KLASIFIKIMIT NDËRKOMBËTAR TË FRASKATIT) NË PROGRAMIN STUDIMOR GJUHË DHE LETËRSI GJERMANE TË FAKULTETIT FILOLOGJIK TË UNIVERSITETIT TË TETOVËS

Në bazë të nenit 173 të Ligjit për arsim të lartë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“, nr. 82/18), nenit 32, 33, 34, 35 dhe 36 të Rregullores për kushtet e veçanta dhe procedurën për zgjedhje në thirrjet mësimore-shkencore, shkencore, mësimore-profesionale dhe të bashkëpunëtorëve në Universitetin e Tetovës nr. **01-4309/2** e datës **01. XII. 2021**, dhe Konkursit për zgjedhje/rizgjedhje të një mësimdhënësi në të gjitha thirrjet mësimore-shkencore në lëmin **Letërsi gjermane, Tjetër** (6.02.02.17, 6.02.02.30 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit) të shpallur më 13. III. 2026 në gazetata ditore „Koha“ dhe „Sloboden Peçat“, Këshilli Mësimor-Shkencor i Fakultetit Filologjik të Universitetit të Tetovës në mbledhjen e mbajtur më 25. III. 2026, solli Vendim me nr. 18-185/1 të datës 26. III. 2026 me të cilin formohet Komision recensues në përbërje:

- 1. Prof. dr. Arbër ÇELIKU (kryetar)** - profesor ordinar në Fakultetin Filologjik të Universitetit të Tetov,
- 2. Prof. dr. Emine SHABANI (anëtar)** - profesor ordinar në Fakultetin Filologjik të Universitetit të Tetov,
- 3. Prof. dr. Salajdin SALIHI (anëtar)** - profesor ordinar në Fakultetin Filologjik të Universitetit të Tetovës.

Si anëtarë të Komisionit recensues, pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar, sjellim këtë

## RAPORT

Në konkursin e shpallur për zgjedhje/rizgjedhje të një mësimdhënësi në të gjitha thirrjet mësimore-shkencore në lëmin **Letërsi gjermane, Tjetër** (6.02.02.17, 6.02.02.30 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit) në afatin e paraparë është paraqitur vetëm kandidati **prof. dr. Hamsi BEHLULI**.

Nga dokumentat e dorëzuara, Komisioni jep këto konstatime.

## 1. Të dhëna biografike dhe arsimimi:

Kandidati prof. dr. Hamsi Behluli është lindur më 15. IV.1968 në Shipkovicë të Tetovës, në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Shkollën fillore e ka kryer në vendlindje, ndërsa atë të mesmen në Gjinnazin e Tetovës, në vitin 1986. Nga viti 1986–1988 ka vijuar me studimet për filozofi në Universitetin e Prishtinës. Në semestrin dimëror 1988 është regjistrua në Universitetin e Hamburgut në Gjermani në drejtimin Gjermanishtja si gjuhë e huaj (Deutsch als Fremdsprache). Më vonë ka studiuar disa semestra edhe në drejtimin e Pedagogjisë.

Në semestrin veror 1992 ka kaluar në drejtimin e Gjermanistikës (si drejtim kryesor), Shkencat Politike dhe Sociologji (si drejtime dytësore). Studimet e magjistraturës i ka kryer me sukses në vitin 1997, me një punimin nga letërsia gjermane, me titull: *Angazhimi i autorëve në letërsinë gjermane pas 1945*, në shembullin e romanit: *Zanzibari apo një shkas tjetër* të autorit Alfred Andersch.

Pas përfundimit të studimeve të magjistraturës Hamsi Behluli është përgatitur për një kualifikim tjetër si gjermanist. Kështu, në mars 2006, ai është regjistruar në studimet e doktoraturës në Universitetin e Evropës Juglindore, në Fakultetin e Gjuhëve, Kulturave dhe Komunikimit. Më 09.09.2009, Dr. Hamsi Behluli, nën udhëheqjen e mentorit të tij Prof. dr. Peter Rau, e ka mbrojtur me sukses tezën e disertacionit nga fusha e letërsisë gjermane: *Udhërrëfimet dhe udhëpërshkrimet gjermane e austriake mbi shqiptare 1910-1930*, duke fituar titullin Doktor i shkencave të filologjisë.

Për përfundimin e këtij projekti, Dr. Hamsi Behluli ka shfrytëzuar bibliotekat e ndryshme në Gjermani dhe Austri, si dhe ato të rajonit të Tetovës, Shkupit, Prishtinës dhe Tiranës. Me këtë projekt ai ka dëshmuar aftësitë e tij shkencore dhe kërkimore në kompletimin e një studimi me peshë të rëndësishme në rrafshin e letërsisë gjermane dhe në marrëdhëniet interkulturore gjermane-shqiptare. Është e ditur se letërsia gjermanishtfolëse, beleristike dhe shkencore mbi Shqipërinë dhe shqiptarët është shumëpërfshirëse dhe historikisht ka një shtrirje të gjerë.

Kandidati Dr. Hamsi Behluli, përmes këtij studimi, mbyll një zbrazëtim në fushën e kërkimeve interkulturore gjermane-shqiptare dhe se ky punim mund të shërbejë si gurthemel dhe model për studiuesit e ardhshëm të gjermanistikës, të cilët do të merren me zhvillimin e mëtejshëm të kësaj fushe mjaft me rëndësi dhe interesante për marrëdhëniet interkulturore gjermane-shqiptare. Punimi i doktoraturës së Behlulit u përgjigjet në mënyrë të shkëlqyer kërkesave të një studimi shkencor të pavarur dhe inovativ, i cili e pasuron në mënyrë thelbësore këtë fushë të letërsisë.

Krahas punimeve shkencore të rangut të lartë dhe atyre profesionale akademike, gjithmonë inovative, siç është punimi i disertacionit të doktoraturës: *Udhërrëfimet dhe udhëpërshkrimet gjermane e austriake mbi shqiptare 1910-1930*, Hamsi Behluli është marrë edhe me përkthime të ndryshme dhe ka publikuar edhe shumë shkrime në revista shkencore filologjike dhe në gazetatat e përditshme, të cilat nga qarqet shkencore janë vlerësuar si studime shkencore solide, kryesisht me temë nga letërsia gjermane: *Udhëpërshkrimi si një medium relevant i kohës 1910-1930*, *Raporti mes dy kulturave*, *Ura mes dy kulturave*, *Letërsia gjermane, një letërsi botërore*, *Karl May: Nëpër vendin e shqiptarëve*, *Mistifikii i*

*vlerave tradicionale në letërsi, Një letërsi e një shteti që nuk ekziston, Udhëpërshkrimet gjermano-austriake mbi shqiptarët, Studiuesit gjermanë mbi autoktoninë shqiptare.*

Dr. Hamsi Behluli gjithashtu ka bërë përkthimin e tekstit nga gjermanishtja në shqip mbi Immanuel Kantin „Doktrina e tij filozofike dhe kushtet e sotme“, përpiluar nga Prof. dr. Peter Rau dhe përkthimin e dramës gjermane *Draussen vor der Tuer* nga shkrimtari gjerman Wolfgang Borchert.

## **2. Veprimtaria mësimore-arsimore:**

Prof. dr. Hamsi Behluli që nga viti 1998 është i angazhuar si asistent në Universitetin e Tetovës, në Katedrën e Gjuhës dhe Letërsisë Gjermane, për lëndët Letërsi gjermane dhe Civilizim gjerman. Në mënyrë të vazhdueshme ka kontribuar në zhvillimin e kësaj katedre në shumë drejtime dhe në veçanti në drejtimin e Letërsisë gjermane dhe Historisë së letërsisë gjermane nëpër epoka.

1998 – 2026 – Angazhim në USHT/UT si ligjërues në katedrën e Gjuhës dhe Letërsisë Gjermane në lëndët:

1. Gjuhë gjermane, Gjuha e sotme gjermane,
2. Historia e vendeve gjermanofolëse (Gjermani, Austri, dhe Zvicër),
3. Hyrje në letërsinë gjermane dhe
4. Letërsi gjermane nëpër epoka I-VII.

Ligjërues dhe kontribuues edhe në cilësinë e shefit të katedrës, veçanërisht në vitet e para pas themelimit të Katedrës së Gjuhës dhe Letërsisë Gjermane (Organizimi i Katedrës, përpilimi i planprogrameve mësimore në katedër, përpilimi i kurrikulave dhe kooperimi me katedrat e tjera në rajon si dhe në UP – Prishtinë dhe UT- Tiranë). Pjesëmarrës dhe kontribues në komisione të ndryshme të Katedrës, gjegjësisht të Fakultetit Filologjik lidhur me funksionimin dhe zhvillimin e Katedrës së Gjermanishtes. Anëtar dhe kontribues në komisione interne të Katedrës mbi mbrojtjen e temave të diplomave. Deri tani ka udhëhequr e ka qenë anëtar komisioni në më shumë se 200 punime diplome.

Në semestrin dimëror 2002/03 angazhohet po ashtu si asistent në Departamentin e Gjuhës dhe Letërsisë Gjermane në Fakultetin Pedagogjik, tash Fakulteti i Gjuhëve, Kulturave dhe i Komunikimit në UEJL, Tetovë. Në zhvillimin e Departamentin të Gjuhës dhe të Letërsisë Gjermane në UEJL, Hamsi Behluli ka dhënë një kontribut të pamohueshëm, duke ofruar kurse të ndryshme nga letërsia gjermane, si dhe lëndët zgjedhore: Gjuhë gjermane, Gjuha gjermane për ekonomi, Gjuha gjermane për studentët e të gjitha fakulteteve dhe Letërsi gjermane në departamentin e Gjermanishtes.

2009 – 2018 - angazhohet në UEJL si ligjërues Prof. dr. ass. i Gjuhës dhe Letërsisë Gjermane: Gjuha gjermane, Letërsia gjermane nëpër epoka. 2009 – 2018 - angazhim në mësimdhënien si Prof. dr. ass. në ciklin e dytë të studimeve të Masterit: Letërsi Gjermane.

Në përputhje me Rregulloren për kushtet e veçanta dhe procedurën për zgjedhje në thirrjet mësimore-shkencore, shkencore, mësimore-profesionale dhe të bashkëpunëtorëve në Universitetin e

Tetovës, kandidati **prof. dr. Hamsi Behluli** ka realizuar gjithsej **79,8 pikë** nga **veprimtaria mësimore-arsimore**.

### **3. Veprimtaria shkencore-hulumtuese:**

a) *Rezultatet shkencore të kandidatit që janë me rëndësi të veçantë për zgjedhje në thirrje shkencore:*

Kandidati prof. dr. Hamsi Behluli në pikëpamje të veprimtarisë hulumtuese-shkencore njihet me disa punime shkencore, të cilat rrjedhin si rezultat i kërkimeve shkencore gjatë periudhës së përgatitjes të punimit të diplomës së magjistraturës dhe doktoraturës. Veprimtaria shkencore-hulumtuese e kandidatit Hamsi Behluli, fillon me përgatitjen dhe mbrojtjen e punimit të magjistraturës e pastaj edhe të punimit të doktoraturës me titull: **Udhërrëfimet dhe udhëpërshkrimet gjermane e austriake mbi shqiptare 1910 – 1930** në Fakultetin Gjuhëve, Kulturave dhe Komunikimit UEJL Tetovë.

Këtë veprimtari e vazhdon edhe më tej me punime të ndryshme, me tema që përfshijnë fushën e letërsisë.

b) *Pasqyra e konferencave, seminareve në vend dhe jashtë vendit:*

#### **3.1. Punime shkencore të botuara në revista profesionale dhe ndërkombëtare:**

1. **Hamsi Behluli:** „Princi Vid – shpresa dhe zhgënjimi i rrugëtimit të tij si princ i shqipëtarëve“ ,Albanologjia - International Journal of Albanology,, Vol.9, No. 17-18, f. 124-127, ISSN 1857-9485 (Print), ISSN: 2545-4919 (Online);

2. Hamsi Behluli – Prezentim dhe botim I artikullit ne gazeten nderkombetare me temën: Kurze Analyse der deutschen Wissenschaftler und Reiseberichterstaer über die Autochthone der albanischen Bevölkerung – Sprache und Kultur Albaniens im 18. Und 19. Jahrhundert: <https://www.peterlang.com/>;

3. Hamsi Behluli - Die Bedeutung deutschsprachiger Reise- und Erlebnisberichte für Albanien und andere Balkanvölker 1910–1940. Ein interkultureller, literarischer, sozialer und politischer Beitrag. : <https://www.peterlang.com/>.

4. Hamsi Behluli -Ismail Kadare pasqyrë letrare dhe kulturore në sytë e lexuesit gjerman - Një reflektim nga një këndvëtrim i huaj mbi poetin shqiptarë. 06 - 08.11.2024 -Konferenca e IX Ndërkombëtare Shkencore të Fakultetit Filologjik të Universitetit të Tetovës, temë: "Ismail Kadare ndërmjet letërsisë shqiptare dhe botërore" 06 - 08 nëntor 2024 Tetovë;

5. Hamsi Behluli - PRETENDENTËT E FRONIT MBRETËROR SHQIPTAR NË SHKRIMET E UDHËPËRSHKRUESVE GJERMANË NË DECENIEN E DYTË TË SHEKULLIT NJËZET.

(20) STUDIME ALBANOLOGJIKE 23 ALBANOLOGY STUDIES 23 5. Nentor 2023 INSTITUTI I TRASHËGIMISË SHPIRTËRORE E KULTURORE TË SHQIPTARËVE – SHKUP INSTITUTE OF SPIRITUAL AND CULTURAL HERITAGE OF THE ALBANIANS – SKOPJE STUDIME ALBANOLOGJIKE 23 ALBANOLOGY STUDIES 23 (2023).

6. Hamsi Behluli - Analytische Themen in den Werken deutscher Autoren der Reiseliteratur zu Beginn des 20. Jahrhunderts auf dem Balkan (2023). Në: **Interkulturelle Räume. Historische Routen und Passagen der Gegenwart unter besonderer Berücksichtigung des Mittelmeerraums**

### **3.2. Pjesëmarrje në konferenca ndërkombëtare:**

1. **Certifikatë** për pjesëmarrje në Konferencën e Nëntë Ndërkombëtare Shkencore të Fakultetit Filologjik me temë: „Ismail Kadare ndërmjet letërsisë shqiptare dhe botërore“, Universiteti i Tetovës, **6-8 nëntor 2024**.
2. **Certifikatë** – INTERNATIONALE TAGUNG „Sprachlichkeit, Fachlichkeit und Interkulturalität im Germanistischen Bereich“ in der Reihe „Berufssprache Deutsch in Theorie und Praxis“ TU Berlin/Fachgebiet „Deutsch als Fremd- und Fachsprache“ in Kooperation mit der Polytechnischen Universität Tirana/Zentrum für Fremdsprachen und der Universität Tirana/Fremdsprachenfakultät 26.-27. September 2024 Tirana, Albanien.
3. **Certifikatë** - INTERNATIONALE TAGUNG Transnationale Kommunikationsprozesse bei der Herausbildung kultureller Identitäten. Interkulturelle Verständigung, sprachliche Diversität und gesellschaftliche Integration im globalisierten universitären Diskurs“ (14.–15. November 2025, Oldenburg Gjermani).
4. **Certifikatë** – 19-22.4.2022 -Gesellschaft für Interkulturelle Germanistik. „Interkulturelle Räume. Historische Routen und Passagen der Gegenwart unter besonderer Berücksichtigung des Mittelmeerraums“Zadar Kroatien.

Në përputhje me Rregulloren për kushtet e veçanta dhe procedurën për zgjedhje në thirrjet mësimore-shkencore, shkencore, mësimore-profesionale dhe të bashkëpunëtorëve në Universitetin e Tetovës, kandidati **prof. dr. Hamsi Behluli** ka realizuar gjithsej **44 pikë** nga **veprimtaria shkencore-hulumtuese**.

## **4. Veprimtaria profesionale-zbatuese:**

### **4.1. Monografi profesionale:**

1. **Hamsi Behluli:** „Historia e letërsisë gjermane : përvijimi i historisë letrare gjermane nëpër epoka nga mesjeta deri më sot“, Arbëria Design, Tetovë, 2025, ISBN 978-608-236-494-0.
2. **Hamsi Behluli:** „Udhëpërshkrimet dhe udhërrëfimet gjermane mbi shqiptarët në vitet 1910–1930“, Arbëria Design, Tetovë, 2025, ISBN 978-608-236-488-9.

### **4.2. Pjesëmarrje në aktivitete promovuese të fakultetit:**

1. Ditët e hapura, Universiteti i Tetovës, prezantim i programit studimor Gjuhë dhe Letërsi Gjermane 2022, 2023, 2024, 2025.

#### **4.3. Pjesëmarrje në seminare:**

1. Seminar me – Hamsi Behluli – Alumnist i Universitetit të Hamburgut dhe merr pjesë në mbledhje, seminare dhe Workshops në rrafshin filologjik në Universitetin e Hamburgut. 100 Jahre Universität Hamburg (100 vite Universiteti i Hamburg) - Studien zur Hamburger Universitäts- und Wissenschaftsgeschichte in vier Bänden Herausgegeben von Rainer Nicolaysen, Eckart Krause und Gunnar B. Zimmermann. Band 1 Allgemeine Aspekte und Entwicklungen. Në këtë publikim vertetohet pozicioni im si Alumnist i Universitetit të Hamburgut, faqja 606-607 dhe Fusnota 99. ISBN 978-3-8353-3866-1.
2. Seminar - INTERNATIONALE TAGUNG Transnationale Kommunikationsprozesse bei der Herausbildung kultureller Identitäten. Interkulturelle Verständigung, sprachliche Diversität und gesellschaftliche Integration im globalisierten universitären Diskurs“ (14.-15. November 2025, Oldenburg Gjermani).
3. Seminar – INTERNATIONALE TAGUNG “Sprachlichkeit, Fachlichkeit und Interkulturalität im Germanistischen Bereich“ in der Reihe „Berufssprache Deutsch in Theorie und Praxis“ TU Berlin/Fachgebiet „Deutsch als Fremd- und Fachsprache“ in Kooperation mit der Polytechnischen Universität Tirana/Zentrum für Fremdsprachen und der Universität Tirana/Fremdsprachenfakultät 26.-27. September 2024 Tirana, Albanien.

Në përputhje me Rregulloren për kushtet e veçanta dhe procedurën për zgjedhje në thirrjet mësimore-shkencore, shkencore, mësimore-profesionale dhe të bashkëpunëtorëve në Universitetin e Tetovës, kandidati **prof. dr. Hamsi Behluli** ka realizuar gjithsej **18 pikë** nga **veprimtaria profesionale-zbatuese**.

## **5. Veprimtari me interes më të gjerë:**

### **5.1. Anëtar i këshillit redaktues të revistës shkencore / profesionale ndërkombëtare:**

1. Anëtar i bordit editorial të revistës ndërkombëtare „Filologjia“, 2022-2025;
2. Anëtar i bordit editorial të revistës ndërkombëtare „Albanologjia“, 2022-2025.

### **5.2. Anëtar i këshillit organizues ose programor i tubimit ndërkombëtar shkencor / profesional:**

1. Anëtar i Këshillit organizativ lokal të Konferencës së VII Ndërkombëtare Shkencore të Fakultetit Filologjik, Universiteti i Tetovës, **16-18 nëntor 2022**;
2. Anëtar i Këshillit organizativ lokal të Konferencës së VIII Ndërkombëtare Shkencore të Fakultetit Filologjik, Universiteti i Tetovës, **15-17 nëntor 2023**;
3. Anëtar i Këshillit organizativ lokal të Konferencës së IX Ndërkombëtare Shkencore të Fakultetit Filologjik, Universiteti i Tetovës, **6-8 nëntor 2024**;
4. Anëtar i Këshillit organizativ lokal të Konferencës së X Ndërkombëtare Shkencore të Fakultetit Filologjik, Universiteti i Tetovës, **12-13 nëntor 2025**.

### **5.3. Anëtar në organet drejtuese të organizatës ndërkombëtare:**

1. Bashkëpunëtor shkencor dhe perfaqësues i Ballkanit Perëndimor në Unionin e Dhomave të Ekonomisë dhe Tregtisë së Gjermanisë në Shkup, Beograd dhe Tiranë.
2. Team Leader dhe Koordinatorë i Programit Ekonomik GIZ (Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit) - Angazhim në rajonin Pollogut, Jugperëndimor dhe Verilindor në Maqedoninë Veriore dhe Projekte në Shqipëri e Kosovë.

Në përputhje me Rregulloren për kushtet e veçanta dhe procedurën për zgjedhje në thirrjet mësimore-shkencore, shkencore, mësimore-profesionale dhe të bashkëpunëtorëve në Universitetin e Tetovës, kandidati **prof. dr. Hamsi Behluli** ka realizuar gjithsej **15 pikë** nga **veprimtaria me interes më të gjerë**.

## 6. Përfundim dhe propozim:

Në bazë të dokumentacionit të dorëzuar dhe njohjes personale të kandidatit, Komisioni recensues i vlerëson pozitivisht aktivitetet në veprimtaritë mësimore-arsimore, shkencore-hulumtuese, profesionale-zbatuese dhe veprimtarinë me interes më të gjerë dhe konstaton se kandidatja **prof. dr. Hamsi Behluli** sipas Ligjit për arsimin e lartë dhe Rregullores për kushtet e veçanta dhe procedurën për zgjedhje në thirrjet mësimore-shkencore, mësimore-profesionale, shkencore, mësimore dhe në bashkëpunëtorë në Universitetin e Tetovës, nr. **01-4309/2** e datës **01. XII. 2021**, dhe ka grumbulluar **156,8 pikë** nga referencat profesionale, me këtë e ka tejkaluar numrin minimal të pikëve që janë të nevojshme për zgjedhjen në thirrjen mësimore-shkencore **profesor ordinar**.

Bazuar në atë që u tha më lart, Komisioni recensues ka nderin dhe kënaqësinë t'i propozojë Këshillit Mësimor-Shkencor të Fakultetit Filologjik të Universitetit të Tetovës, **prof. dr. Hamsi Behluli** të zgjidhet në thirrjen mësimore-shkencore **profesor ordinar** në lëmin Letërsi gjermane, Tjetër (6.02.02.17, 6.02.02.30 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit) në programin studimor Gjuhë dhe Letërsi Gjermane të Fakultetit Filologjik të Universitetit të Tetovës.

Tetovë, më 08.06. 2026

Komisioni recensues:

**1. Prof. dr. Arbër ÇELIKU** (kryetar) - profesor ordinar në Fakultetin Filologjik të Universitetit të Tetovës

\_\_\_\_\_

**2. Prof. dr. Emine SHABANI** (anëtar) – profesor ordinar në Fakultetin Filologjik të Universitetit të Tetovës

\_\_\_\_\_

**3. Prof. dr. Salajdin SALIHI** (anëtar) - profesor ordinar në Fakultetin Filologjik të Universitetit të Tetovës

\_\_\_\_\_

## FORMULARI 1

KUSHTET E PËRGJITHSHME PËR ZGJEDHJE NË TITUJ MËSIMORË-SHKENCORË, SHKENCORË,  
MËSIMORË-PROFESIONAL DHE BASHKËPUNËTORË

Kandidati: **Hamsi Behluli**

Institucioni: **Fakulteti Filologjik, Universiteti i Tetovës**

Fusha shkencore: **Letërsi gjermane, Tjetër (6.02.02.17, 6.02.02.30 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit)**

### KUSHTET E PËRGJITHSHME PËR ZGJEDHJE NË TITULLIN MËSIMOR-SHKENCOR – PROFESOR ORDINAR

Nr.	KUSHTET E PËRGJITHSHME	Plotësimi i kushteve të përgjithshme po/jo
1	Titulli shkencor - doktor i shkencave nga fusha shkencore për të cilën zgjidhet  Emri i sferës shkencore: <b>Shkencat humane (6)</b> , fusha shkencore: <b>Gjuhët dhe letërsia (6.02)</b> , nënfusha shkencore: <b>Letërsia (6.02.02)</b> , lëmia shkencore: <b>Letërsi gjermane (6.02.02.17), Tjetër (6.02.02.30)</b>	po
2	Të publikuara së paku 6 (gjashtë) punime shkencore <sup>1</sup> në publikim shkencor referent në pajtim me Ligjin për arsimin e lartë, në pesë vitet e fundit para shpalljes së konkursit për zgjedhje	po
2.1	Revista shkencore në të cilën punimet që publikohen u nënshtrohen recensioneve dhe e cila është e indeksuar në së paku një bazë elektronike të revistave me punime të qasshme në internet, siç janë: Ebsco, Emerald, Scopus, Web of Science, Journal Citation Report, SCImago Journal Rank ose bazë tjetër të revistave, të cilën do ta përcaktojë Këshilli Kombëtar për Arsimin të Lartë  <b>I</b> 1. Emri i revistës shkencore: <b><i>Albanologjia - International Journal of Albanology</i></b> 2. Emri i bazës elektronike të revistave: <b><i>CEEOL, EBSCO, IndexCopernicus International, ISI Impact Factor (IIF) = 0.0346 etc</i></b> 3. Titulli i punimit: <b><i>Princi Vid – shpresa dhe zhgënjimi i rrugëtimit të tij si princ i shqipëtarëve</i></b> 4. Data e publikimit: <b>2023</b>  <b>II</b> 1. Emri i revistes: <b><i>STUDIME ALBANOLOGJIKE 23 ALBANOLOGY STUDIES 23 (2023)</i></b>	po

<sup>1</sup> Për kandidatin, i cili ka më tepër se 6 (gjashtë) punime shkencore në publikime shkencore referente, komisioni recensues punimet shkencore do t'i përmend, do t'i shënojë dhe vlerësojë me pikë në Formularin 2.

2. Emri i bazes elektronike: **Botim i shkrimit:(Revistë e shkencave albanologjike) : Research-Scientific Journal on Albanology)**
3. Titulli i punimit: **PRETENDENTËT E FRONIT MBRETËROR SHQIPTAR NË SHKRIMET E UDHËPËRSHKRUESVE GJERMANË NË DECENIEN E DYTË TË SHEKULLIT NJËZET**
4. Data e publikimit: **2025**

### III

- 1.Emri i revistës shkencore: **Transnationale - Kommunikationsprozesse bei der Herausbildung kultureller Iden täten. Interkulturelle Verständigung, sprachliche Diversität und gesellschaftliche Integration im globalisierten universitären Diskurs**
- 2.Emri i bazës elektronike të revistave: **Peter Lang Verlag ne botim ne online dhe print 2026 <https://www.peterlang.com/> CEEOL, EBSCO, IndexCopernicus International, ISI Impact Factor (IIF) = 0.0346 etc**
3. Titulli i punimit: **Kurze Analyse der deutschen Wissenschaftler und Reiseberichtersta er über die Autochthone der albanischen Bevölkerung – Sprache und Kultur Albaniens im 18. Und 19. Jahrhundert:**
4. Data e publikimit: **2026**

### IV

1. Emri i revistës shkencore: **Sammelband Ex linguarum studiis, pontes inter culturas. Sprachliche Bildung und kulturelle Identitätsentwicklung im deutsch-albanischen Kontext.**
2. emri i bates elektronike të revistave: Peter Lang Verlag ne botim ne online dhe print 2026 <https://www.peterlang.com/> CEEOL, EBSCO, IndexCopernicus International, ISI Impact Factor (IIF) = 0.0346 etc **CEEOL, EBSCO, IndexCopernicus International, ISI Impact Factor (IIF) = 0.0346 etc**
3. Titulli i punimit: **Die Bedeutung deuHamsi Behluli. Deutschsprachiger Reise- und Erlebnisberichte für Albanien und andere Balkanvölker 1910–1940. Ein interkultureller, literarischer, sozialer und politischer Beitrag.**
4. Data e publikimit: **2026**

### V

1. Emri i revistës shkencore: **Interkulturelle Räume. Historische Routen und Passagen der Gegenwart unter besonderer Berücksichtigung des Mittelmeerraums**
2. Emri i bazës elektronike të revistave: **<https://conference.unizd.hr//gig/wp-content/uploads/sites/32/2021/03/000-Book-of-Abstracts-GiG-2022.pdf> CEEOL, EBSCO, IndexCopernicus International, ISI Impact Factor (IIF) = 0.0346 etc**
3. Titulli i punimit: **Analytische Themen in den Werken deutscher Autoren der Reiseliteratur zu Beginn des 20.Jahrhunderts auf dem Balkan.**
4. Data e botimit: **2023**

3	<p>Libër mësimor i recensuar dhe publikuar, monografi, praktikum ose përmbledhje detyrash nga fusha shkencore për të cilën zgjidhet</p> <p style="text-align: center;"><b>I</b></p> <p>1. Titulli i librit mësimor, monografisë, praktikumit ose përmbledhjes së detyrave: „<b>Historia e letërsisë gjermane : përvijimi i historisë letrare gjermane nëpër epoka nga mesjeta deri më sot</b>“</p> <p>2. Vendi dhe data e botimit: <b>2025</b></p> <p style="text-align: center;"><b>II</b></p> <p>1. Titulli i librit mësimor, monografisë, praktikumit ose përmbledhjes së detyrave: „<b>Udhëpërshkrimet dhe udhërrëfimet gjermane mbi shqiptarët në vitet 1910-1930</b>“</p> <p>2. Vendi dhe data e botimit: <b>2025</b></p>	<b>po</b>
4	<p>Zgjedhja e mëparshme në titullin mësimor-shkenco – profesor inordinar, data dhe numri i buletinit: <b>Vendim për thirrje mësimore-shkencore profesor inordinar e datës 22. IX. 2021, nr. 18-973/1, i datës 23. IX. 2021 r., Buletini me nr. 194, i datës 16. VII. 2021</b></p>	<b>po</b>
5	<p><b>Ka aftësi për realizimin e veprimtarisë në arsimin e lartë</b></p> <p>1. Emri i institucionit ku janë fituar aftësisë dhe shkathhtësitë për realizimin e veprimtarisë së arsimit të lartë: <b>Universiteti i Tetovës</b></p> <p>2. Lloji i trajnimit/përvoja/arsimimi për fitimin e aftësive dhe shkathhtësive për realizimin e veprimtarisë së arsimit të lartë: <b>Mësimdhënie</b></p> <p>3. Periudha e fitimit të shkathhtësive për realizimin e veprimtarisë së arsimit të lartë: <b>1998-2026</b></p>	<b>po</b>

## FORMULARI 2

### PËR RAPORTIN E ZGJEDHJES NË TITUJ MËSIMORË-SHKENCORË, SHKENCORË DHE MËSIMORË-PROFESIONAL

Kandidati: **Hamsi Behluli**

Institucioni: **Fakulteti Filologjik, Universiteti i Tetovës**

Fusha shkencore: **Letërsi gjermane, Tjetër (6.02.02.17, 6.02.02.30 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit)**

### I. VEPRIMTARIA MËSIMORË-ARSIMORË

Nr.	Emri i aktivitetit					Pikët
<b>1</b>	<b>Mbajtja e ligjëratave</b> (cikli i parë i studimeve)	Pikët	Fondi	Javët	Sem.	<b>48</b>
<b>1.1</b>	<b>Letërsi gjermane I</b> (Gjuhë dhe Letërsi Gjermane)	0,04	2	15	5	<b>6</b>
<b>1.2</b>	<b>Letërsi gjermane II</b> (Gjuhë dhe Letërsi Gjermane)	0,04	2	15	5	<b>6</b>
<b>1.3</b>	<b>Letërsi gjermane III</b> (Gjuhë dhe Letërsi Gjermane)	0,04	2	15	5	<b>6</b>
<b>1.4</b>	<b>Letërsi gjermane IV</b> (Gjuhë dhe Letërsi Gjermane)	0,04	2	15	5	<b>6</b>
<b>1.5</b>	<b>Letërsi gjermane V</b> (Gjuhë dhe Letërsi Gjermane)	0,04	2	15	5	<b>6</b>
<b>1.6</b>	<b>Letërsi gjermane VI</b> (Gjuhë dhe Letërsi Gjermane)	0,04	2	15	5	<b>6</b>
<b>1.7</b>	<b>Letërsi gjermane VII</b> (Gjuhë dhe Letërsi Gjermane)	0,04	2	15	5	<b>6</b>
<b>1.8</b>	<b>Letërsi gjermane VIII</b> (Gjuhë dhe Letërsi Gjermane)	0,04	2	15	5	<b>6</b>
<b>2</b>	<b>Mbajtja e ligjëratave</b> (cikli i dytë i studimeve)	Pikët	Fondi	Javët	Sem.	<b>0,5</b>
<b>2.1</b>	<b>Metodika e mësimdhënies së letërsisë gjermane</b> (Metodika e Mësimdhënies së Gjuhës Gjermane)	0,05	2	5	1	<b>0,5</b>
<b>3</b>	<b>Konsultime me studentët</b>					<b>0,8</b>
<b>3.1</b>	Konsultimet me studentë	40x10x0.002				<b>0,8</b>
<b>4</b>	<b>Mentorim</b>					<b>26</b>
<b>4.1.</b>	Mentor i temave të diplomës	30x0.2				<b>6</b>
<b>4.2.</b>	Mentor i temave të magjistraturës	20x1				<b>20</b>
<b>5</b>	<b>Anëtar i komisioneve</b>					<b>4,5</b>
<b>5.1.</b>	Anëtar komisioni për mbrojtjen e punimeve të diplomës, cikli I	15x0.2				<b>3</b>
<b>5.2.</b>	Anëtar komisioni për mbrojtjen e punimeve të magjistraturës, cikli II	5x0.3				<b>1,5</b>
<b>Gjithsej (1+2+3+4+5)</b>						<b>79,8</b>

## II. VEPRIMTARIA SHKENCORE-HULUMTUESE

Nr.	Emri i aktivitetit	Pikët
<b>1</b>	<b>Teza të mbrojtura</b>	<b>12</b>
<b>1.1.</b>	<b>Hamsi Behluli:</b> „Angazhim i autorëve në letërsinë gjermane pas 1945, në shembullin e romanit “Zanzibari apo një shkas tjetër “ i autorit Alfred Andersch“ nën mentorim të Prof. dr. Horst Ohde 30.04.1997, teza e mbrojtur e magjistraturës, Universiteti i Hamburgit.	<b>4</b>
<b>1.2.</b>	<b>Hamsi Behluli:</b> „Udhërrëfimet dhe udhëpërshkrimet gjermane e austriake mbi shqiptarë 1910 – 1930” me 09.09.2009 teza e mbrojtur e doktoraturës, Fakulteti i Gjuhëve, Kulturave dhe Komunikimit UEJL në Tetovë.	<b>8</b>
<b>2</b>	<b>Punim me rezultate shkencore origjinale, i publikuar në revistë shkencore në të cilën punimet që botohen u nënshtrohen recensimit dhe e cila është e indeksuar së paku në një bazë elektronike të revistave me punime të qasshme në internet, siç janë: Ebsco, Emerald, Scopus, Web of Science, Journal Citation Report, SCImago Journal Rank, ose bazë tjetër të revistave të cilën e përcakton e Këshilli nacional për arsimin e lartë</b>	<b>25</b>
<b>2.1</b>	53rd International Scientific Conference 28 – 31. 05.2026, Budva, Montenegro Hamsi Behluli - GERMAN AND AUSTRIAN DISCOURSES ON ALBANIANS IN THE EARLY TWENTIETH CENTURY AND THE IMPORTANCE OF TRAVEL WRITING , (Diskurset Gjermane dhe austriake mbi shqiptarët në fillim të shekullit XX dhe rëndësia e shkrimeve të udhëpërshkrimeve) KNOWLEDGE -International Journal, Vol 76.5. 28 – 31. 05.2026, S 679 -694	<b>5</b>
<b>2.2</b>	53rd International Scientific Conference 28 – 31. 05.2026, Budva, Montenegro Hamsi Behluli - GERMAN LITERATURE AFTER 1945: LITERARY RECONSTRUCTION AND SOCIO-CULTURAL DISCOURSE IN POSTWAR GERMANY (Letërsia gjermane pas viti 1945: Rindërtimi letrar dhe diskursi socio-kulturor në Gjermaninë e pasluftes) , KNOWLEDGE -International Journal, Vol 76.5. 28 – 31. 05.2026, S 691 -684	<b>5</b>
<b>2.3</b>	19TH INTERNATIONAL SCIENTIFIC CONFERENCE OF THE FACULTY OF PHILOLOGY Hamsi Behluli- „Ismail Kadare between Albanian and world literature” November 06 - 08, 2024 Ismail Kadare pasqyrë letrare dhe kulturore në sytë e lexuesit gjerman - Një reflektim nga një këndvështrim i huaj mbi poetin shqiptarë.	<b>5</b>
<b>2.4</b>	Revisës ALBANOLOGJIA State University Tetovo North Macedonia Vol. 9   No. 16-18 November 2022 - ALBANOLOGJIA International Journal of Albanology Hamsi Behluli: PRINCE WIED – THE HOPE AND DISAPPOINTMENT OF HIS JOURNEY AS PRINCE OF THE ALBANIANS PRINCI VID	<b>5</b>
<b>2.5</b>	INSTITUTI I TRASHËGIMISË SHPIRTËRORE E KULTURORE TË SHQIPTARËVE – SHKUP INSTITUTE OF SPIRITUAL AND CULTURAL HERITAGE OF THE ALBANIANS – SKOPJE STUDIME ALBANOLOGJIKE 23 ALBANOLGY STUDIES 23 (2023) Botim i shkrimit: (Revistë e shkencave albanologjike) (Research-Scientific Journal on Albanology) Hamsi Behluli - PRETENDENTËT E FRONIT MBRETËROR SHQIPTAR NË SHKRIMET E UDHËPËRSHKRUESVE GJERMANË NË DECENIEN E DYTË TË SHEKULLIT NJËZET.	<b>5</b>

	(20) STUDIME ALBANOLOGJIKE 23 ALBANOLOGY STUDIES 23	
<b>3</b>	<b>Punim me rezultate origjinale shkencore/profesionale, i publikuar në përmbledhje të punimeve shkencore të recensuara, të prezantuara në tubim shkencor ndërkombëtar, në të cilin anëtarët e këshillit organizues ose programor janë nga së paku tre shtete</b>	<b>3</b>
<b>3.1</b>	PRETENDENTËT E FRONIT MBRETËROR SHQIPTAR NË SHKRIMET E UDHËPËRSHKRUESVE GJERMANË NË DECENIEN E DYTË TË SHEKULLIT NJËZET, STUDIME ALBANOLOGJIKE 23 ALBANOLOGY STUDIES 23 (2023)	<b>3</b>
<b>4</b>	<b>Pjesëmarrje në konferenca e takime shkencore me prezantim oral</b>	<b>4</b>
<b>4.1</b>	<b>Certifikatë</b> për pjesëmarrje në Konferencën e Nëntë Ndërkombëtare Shkencore të Fakultetit Filologjik me temë: „Ismail Kadare ndërmjet letërsisë shqiptare dhe botërore“, Universiteti i Tetovës, <b>6-8 nëntor 2024</b>	<b>1</b>
<b>4.2</b>	<b>Certifikatë</b> – Seminari nderkombetare XIX i Albanologjise Hamsi Behluli – Dialogu kulturore ne mes letersise shqipe dhe asaj boterore. 25.09.2025 Tetove Maqedonia e Veriut	<b>1</b>
<b>4.3</b>	<b>Certifikatë</b> -53rd International Scientific Conference 28 – 31. 05.2026, Budva, Montenegro Hamsi Behluli - GERMAN AND AUSTRIAN DISCOURSES ON ALBANIANS IN THE EARLY TWENTIETH CENTURY AND THE IMPORTANCE OF TRAVEL WRITING , KNOWLEDGE -International Journal, Vol 76.5.	<b>1</b>
<b>4.4</b>	<b>Certifikatë</b> – 53rd International Scientific Conference 28 – 31. 05.2026, Budva, Montenegro Hamsi Behluli - GERMAN LITERATURE AFTER 1945: LITERARY RECONSTRUCTION AND SOCIO-CULTURAL DISCOURSE IN POSTWAR GERMANY , KNOWLEDGE -International Journal, Vol 76.5. 28 – 31. 05.2026, S 691 -684	<b>1</b>
<b>Gjithsej (1+2+3+4)</b>		<b>44</b>

### III. VEPRIMTARIA PROFESIONALE-ZBATUESE

Nr.	Emri i aktivitetit	Pikët
<b>1</b>	<b>Monografi profesionale</b>	<b>16</b>
<b>1.1</b>	<b>Hamsi Behluli:</b> „Historia e letërsisë gjermane : përvijimi i historisë letrare gjermane nëpër epoka nga mesjeta deri më sot“, Arbëria Design, Tetovë, 2025, ISBN 978-608-236-494-0	<b>8</b>
<b>1.2</b>	<b>Hamsi Behluli:</b> „Udhëpërshkrimet dhe udhërrëfimet gjermane mbi shqiptarët në vitet 1910–1930“, Arbëria Design, Tetovë, 2025, ISBN 978-608-236-488-9	<b>8</b>
<b>2</b>	<b>Pjesëmarrje në aktivitete promovuese të fakultetit</b>	<b>2</b>
<b>2.1</b>	Ditët e hapura, Universiteti i Tetovës, prezantim i programit studimor Gjuhë dhe Letërsi Gjermane 2022, 2023, 2024, 2025	4 x 0,5 = 2
<b>Gjithsej (1+2)</b>		<b>18</b>

### IV. VEPRIMTARIA ME INTERES MË TË GJERË

Nr.	Emri i aktivitetit	Pikët
<b>1</b>	<b>Anëtar i këshillit redaktues të revistës ndërkombëtare shkencore/profesionale</b>	<b>7</b>
<b>1.1</b>	Anëtar i bordit editorial të revistës ndërkombëtare „Filologjia“, 2022-2025 (nr. 24-25 [2025], nr. 22-23 [2024], nr. 20-21 [2023], nr. 19 [2022], nr. 17-18 [2022])	4 x 1 = <b>4</b>

1.2	Anëtar i bordit editorial të revistës ndërkombëtare „Albanologjia“, 2023-2025 (nr. 23-24 [2025], nr. 21-22 [2024], nr. 19-20 [2023])	3 x 1 = 3
2	<b>Anëtar i këshillit organizues ose programor i tubimit ndërkombëtar shkencor/profesional</b>	4
2.1	Anëtar i Këshillit organizativ lokal të Konferencës së VII Ndërkombëtare Shkencore të Fakultetit Filologjik, Universiteti i Tetovës, <b>16-18 nëntor 2022</b>	1
2.2	Anëtar i Këshillit organizativ lokal të Konferencës së VIII Ndërkombëtare Shkencore të Fakultetit Filologjik, Universiteti i Tetovës, <b>15-17 nëntor 2023</b>	1
2.3	Anëtar i Këshillit organizativ lokal të Konferencës së IX Ndërkombëtare Shkencore të Fakultetit Filologjik, Universiteti i Tetovës, <b>6-8 nëntor 2024</b>	1
2.4	Anëtar i Këshillit organizativ lokal të Konferencës së X Ndërkombëtare Shkencore të Fakultetit Filologjik, Universiteti i Tetovës, <b>12-13 nëntor 2025</b>	1
3	<b>Anëtar në organet drejtuese të organizatës ndërkombëtare</b>	4
3.1	Bashkëpunëtor shkencor dhe perfaqësues i Ballkanit Perëndimor në Unionin e Dhomave të Ekonomisë dhe Tregtisë së Gjermanisë në Shkup, Beograd dhe Tiranë	2
3.2	Team Leader dhe Koordinatorë i Programit Ekonomik GIZ (Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit) - Angazhim në rajonin Pollogut, Jugperëndimor dhe Verilindor në Maqedoninë Veriore dhe Projekte në Shqipëri e Kosovë	2
<b>Gjithsej (1+2+3)</b>		<b>15</b>

<b>REFERENCAT PROFESIONALE TË KANDIDATIT PËR ZGJEDHJE NË THIRRJE</b>		<b>Pikë</b>
<b>I.</b>	<b>VEPRIMTARIA MËSIMORE-ARSIMORE</b>	<b>79,8</b>
<b>II.</b>	<b>VEPRIMTARIA SHKENCORE-HULUMTUESE</b>	<b>44</b>
<b>III.</b>	<b>VEPRIMTARIA PROFESIONALE-ZBATUESE</b>	<b>18</b>
<b>IV.</b>	<b>VEPRIMTARIA ME INTERES MË TË GJERË</b>	<b>15</b>
<b>Gjithsej</b>		<b>156,8</b>

Tetovë, më 08.06.2026

Komisioni recensues:

1. Prof. dr. Arbër ÇELIKU (kryetar) - profesor ordinar në Fakultetin Filologjik të Universitetit të Tetovës

\_\_\_\_\_

2. Prof. dr. Emine SHABANI (anëtar) – profesor ordinar në Fakultetin Filologjik të Universitetit të Tetovës

\_\_\_\_\_

3. Prof. dr. Salajdin SALIHI (anëtar) - profesor ordinar në Fakultetin Filologjik të Universitetit të Tetovës

\_\_\_\_\_